AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Nëntor 2023

22.12.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin nëntor 2023.

Rritet skema për pensionet paraplegjik dhe tetraplegjik në nëntor 2023, krahasuar me nëntor 2022

Në muajin nëntor 2023, nga skema për pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike kanë përfituar 2 961 persona, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (që ishte 2 516 përfitues), vërehet një rritje prej 17,7%.

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

Përfituesit e pensioneve dhe skemave tjera sociale	Muaji/Viti		11.2023/ 11.2022
	11.2022	11.2023	
Skema e ndihmës sociale	23 100	20 353	-11,9%
Pensionet bazike të moshës	143 578	152 470	6,2%
Pensionet kontributpaguese të moshës	48 240	49 072	1,7%
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	19 284	20 240	5,0%
Pensionet e Trepçës	1 758	1 429	-18,7%
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	693	762	10,0%
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1 278	1 315	2,9%
Skema e të verbërve	1 849	1 885	1,9%
Pensionet Familjare	3 252	2 959	-9,0%
Pensionet e Invalidëve të punës	60	47	-21,7%
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2 516	2 961	17,7%
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	12 856	13 607	5,8%
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	13 074	12 877	-1,5%
Veteranët	36 802	36 851	0,1%
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	2 922	3 323	13,7%

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin nëntor 2023, krahasuar me muajin nëntor 2022, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-21,7%); skema për pensionet e Trepçës (-18,7%); skema e ndihmës sociale (-11,9%) skema për pensionet familjare (-9,0%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,5%).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin nëntor 2023, krahasuar me muajin nëntor 2022 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike (17,7%); skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (13,7%); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) (10,0%); skema e pensioneve bazike të moshës (6,2%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,8%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (5,0%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (2,9%); skema e kompensimeve për personat e verbër (1,9%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (1,7%); skema për veteranët e luftës (0,1%).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin nëntor 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare